



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.71

Prishtinë, më 29.11.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-204

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi dhe Shpejtim Bulliqi.

Munguan: Sërgjan Popoviq, Mufera Shinik, Shukrije Bytyçi dhe Teuta Haxhiu.

Përfaqësues të ftuar: Xhevdet Smakiqi, ekspert i angazhuar i Komisionit.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të KDI-së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 21.11.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;**
- 4. Diskutim lidhur me Trashëgiminë Kulturore të Kosovës;**
- 5. Diskutim lidhur me sigurinë në shkolla;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të datës: 21.11.2016

Procesverbalet nga mbledhjet, e mbajtura më 21.11.2016, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Komisioni përfundoi me shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive. Amendamentet e propozuara u dërgohen për shqyrtim Komisioneve të përhershme.

Amendamenti 1

Në titullin e projektligjit, pas fjalës “dhunës”, shtohet teksti ” dhe dukurive negative”.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1.Me këtë ligj përcaktohen masat për parandalimin, sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, obligimet e organizatorit të ngjarjeve sportive, kompetencat e organeve zyrtare për shqiptimin e masave për parandalimin, sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, kurdisjeve dhe dukurive tjera.

Neni 1, paragrafi 2, referenca ”01.11.1985 CETS”, zëvendësohet me referencën ”19.08.1985 ETS”.

Amendamenti 3

Neni 2, pas nënparagrafit 1.14, shtohet nënparagraf i ri si vijon:

1.15. Kurdisje - veprim që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kufizon, dëmton apo eliminon konkurrencën reale në garat sportive, përmes kurdisjeve të rezultateve të ndërlidhura me bastoret sportive.

Amendamenti 4

Neni 3, paragrafi 2, fjala ”pikën”, zëvendësohet me fjalën ”paragrafin”.

Amendamenti 5

Neni 4, titulli riformulohet si vijon:

”Dhuna, sjelljet e palejuara, kurdisjet dhe dukuritë negative në ngjarjet sportive”

Neni 4, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Dhunë, sjellje e palejuar, kurdisje dhe dukuri negative në ngjarjet sportive konsiderohet :

Neni 4, nënparagrafi 1.7, pas fjalës “objektit”, shtohet teksti: ”dhe terrenit”.

Neni 4, nënparagrafi 1.10, riformulohet si vijon:

1.10. Futja dhe përdorimi i mjeteve piroteknike, mjeteve të forta dhe mjeteve tjera në objektet sportive, përdorimi i të cilave mund të shkaktojnë pasiguri të pjesëmarrësve në ngjarjet sportive;

Neni 4, pas nënparagrafit 1.12, shtohen dy nënparagraf të rinj si vijon:

1.13 Rezultatet të cilat nuk janë arritur mbi parimin e konkurrencës reale dhe sipas meritës.

1.14. Çdo manipulim dhe kurdisje e rezultateve në garat sportive vendore dhe ndërkombëtare.

Amendamenti 6

Kapitulli II, titulli riformulohet si vijon:

”MASAT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS, SJELLJEVE TË PALEJUARA, DUKURIVE NEGATIVE DHE KURDISJEVE NË NGJARJET SPORTIVE”

Amendamenti 7

Neni 5 paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Me qëllim të parandalimit të dhunës, sjelljeve të palejuara, dukurive negative, manipulimeve dhe kurdisjeve në ngjarjet sportive, udhëheqësit, zyrtarët e KOK, anëtarët e Federatave, klubeve sportive dhe organizatori i ngjarjes sportive obligohen që:

Neni 5 nënparagrafi 1.3 fjala “shkuarjes” zëvendësohet me fjalën ”pjesëmarrjes”.

Neni 5 pas nënparagrafit 1.5 shtohen nënparagrafët e ri si vijon:

1.6. Të njoftojnë me shkrim organet zyrtare: Policinë e Kosovës, Prokurorinë e Shtetit dhe Këshillin Kombëtar për parandalimin e dhunës, sjelljeve të palejuara, dukurive negative dhe kurdisjeve në ngjarjet sportive.

1.7. Të raportojnë me shkrim për rastet kur ka informata për manipulim apo kurdisje të ndeshjes sportive. Raporti iu dërgohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh organeve kompetente sipas nënparagrafit 1.6 të këtij neni.

1.8. Të caktojnë zyrtarë apo kompani profesionale monitoruese vendore ose ndërkombëtare për monitorimin e ngjarjeve sportive në Federatat përkatëse.

1.9. Udhëheqësit, zyrtarët e KOK-ut, anëtarët e Federatave, klubeve sportive apo organizatori i ngjarjes sportive, janë të obliguar që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që në çdo garë vendore dhe ndërkombëtare sportive rezultatet të jenë mbi parimin e konkurrencës reale të drejtë dhe sipas meritës.

1.10. Udhëheqësit, zyrtarët e KOK, anëtarët e Federatave, klubeve sportive dhe organizatori i ngjarjes sportive, janë përgjegjës, që të parandalojnë çdo dukuri negative të manipulimit dhe kurdisjes së rezultateve në garat sportive vendore dhe ndërkombëtare.

Amendamenti 8

Neni 6 nënparagrafi 2.1 fjala “në objektin” zëvendësohet me fjalën “nga objekti”

Neni 6 nënparagrafi 2.8 pas fjalës “kujdestar” shtohet fjala “i sigurisë”

Amendamenti 9

Pas nenit 6 shtohet nen i ri si vijon:

Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive

1. Ministria, sipas këtij ligji themelon Këshillin Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive (në tekstin e mëtejme Këshilli).

2. Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, prej të cilëve:

2.1. një anëtarë nga Prokuroria e Shtetit – kryetar;

2.2. një anëtarë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë;

2.3. një anëtarë nga Komiteti Olimpik i Kosovës;

2.4. një anëtarë nga Federata përkatëse dhe

2.5. një anëtarë nga Ministria.

3. Organizimi dhe koordinimi i punës së Këshillit bëhet nga Ministria.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Amendamenti 10

Neni 7 paragrafi 1, para fjalës “KOK-u” shtohet fjala “Këshilli”

Amendamenti 11

Neni 9 paragrafi 2 fshihet teksti ”: letërnjoftim, pasaportë etj., për të gjitha rastet e shitjes prej 4 deri në 7 bileta.”

Neni 9 paragrafi 6 riformulohet si vijon:

“Policia e Kosovës dhe Federata përkatëse mbanë evidencë me të dhëna të personave që kanë qenë të përfshirë në akte të dhunës në ngjarjen sportive.”

Amendamenti 12

Neni 11 nënparagrafi 1.6 riformulohet si vijon: "Të ketë hapësirën e caktuar për anëtarët e Këshillit, personin e autorizuar nga Policia e Kosovës dhe zyrtarët kompetentë për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në ngjarjen sportive. Këta persona, nga kjo hapësirë, duhet të kenë shikim të qartë të terrenit dhe të tifozëve – pjesëmarrësve;"

Amendamenti 13

Neni 12, paragrafi 1 dhe 2, riformulohen si vijon:

1. Policia e Kosovës në rastin e mbajtjes së ngjarjes sportive me rrezikshmëri të lartë ndërmerr masat e nevojshme për pengimin e dhunës dhe sjelljeve të palejuara.
2. Masat të cilat i ndërmerr Policia e Kosovës, por që nuk kufizohen vetëm në masat vijuese:

Amendamenti 14

Neni 13 paragrafi 2 fjala "pra" fshihet.

Amendamenti 15

Neni 14 në titullin e tij fshihet fjala "subsidiar"

Amendamenti 16

Neni 15 paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Me gjobë prej dhjetëmijë euro (10,000 €) deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000 €) do të gjobiten Federatat e sportit, klubet sportive, shoqëritë sportive ose personat e tjerë juridikë që organizojnë ngjarjet sportive, nëse nuk:

- 1.1 mundësojnë mbajtjen e sigurt të ngjarjes sportive të paraparë me nenin 3 të këtij ligji.
- 1.2. kanë kontroll për zbatimin e masave të parapara me nenin 3 të këtij ligji;
- 1.3. ndërmarrin masat preventive të parapara me nenin 7 të këtij ligji;
- 1.4. trajnojnë – aftësojnë ose nuk e angazhojnë shërbimin kujdestar adekuat;
- 1.5. bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës;
- 1.6. gjatë mbajtjes së ngjarjes sportive nuk sigurojnë praninë e shërbimit mjekësor, dhe nuk bashkëpunojnë me organet kompetente;
- 1.7. gjatë mbajtjes së ngjarjes sportive nuk sigurojnë vende të veçanta për zyrtarët e organeve kompetente ose të organizatave, shërbimeve publike dhe zyrtarëve publikë të cilët kanë obligim që ta monitorojnë ngjarjen sportive;
- 1.8. shpallin me rrezikshmëri të lartë ngjarjen sportive përkatëse;
- 1.9. ndërmarrin masat përkatëse para, gjatë dhe pas ngjarjes sportive me rrezikshmëri të lartë sipas nenit 8 të këtij ligji;

1.10. sigurojnë mbajtjen e evidencave të parapara për shitjen e biletave të ngjarjes sportive me rrezikshmëri të lartë dhe nuk ia paraqesin ato Policisë së Kosovës sipas kërkesës zyrtare;

1.11. sigurojnë që për ngjarje sportive me rrezikshmëri të lartë biletat t'iu shiten vetëm personave që kanë dokumente identifikimi;

1.12. sigurojnë se një personi mund t'i shiten vetëm deri në 7 bileta;

1.13. sigurojnë se nuk u lejohej hyrja në objekt sportiv, gjatë kohës sa zhvillohet ngjarja sportive, personave më të ri se 16 vjeç, pa kujdesin e prindit ose kujdestarit ligjor;

1.14. sigurojnë nëse shitja e biletave bëhet në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë ligj;

1.15. sigurojnë që ngjarja sportive të zhvillohet në objektin e përshtatshëm sportiv;

1.16. sigurojnë nëse shitet alkooli në objektin sportiv edhe përkundër ndalesës, dhe personat përgjegjës nuk e raportojnë atë tek organet kompetente.

Amendamenti 17

Neni 16 riformulohet si vijon:

Për veprimet e kryera të cilat janë paraparë me nenin 4 të këtij ligji personi fizik mund të dënohet me gjobë prej njëmijë euro (1000 €) deri në pesëmijë euro (5.000 €).

Amendamenti 18

Neni 17 riformulohet si vijon:

Krahas dënimit për kundërvajtje, personave fizike dhe juridike që kanë kryer vepra penale në ngjarjet sportive u shqiptohen edhe masa të tjera të parapara me Kodin Penal.

Amendamenti 19

Neni 18, paragrafi 3, riformulohet dhe bëhet nen i ri me tekst si vijon:

”Aktet nënligjore

Ministria brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.”

4. Diskutim lidhur me Trashëgiminë Kulturore të Kosovës

Nait Hasani, e hapi diskutimin mbi Trashëgiminë Kulturore, fillimisht duke i falënderuar përfaqësuesit e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për angazhimin e tyre. Ai tha se arsyeja pse janë ftuar përfaqësuesit e Këshillit në Komision është që të njihemi me punën dhe

aktivitetet që ata bëjnë, çështjen e buxhetit për këtë Këshill, si dhe çështje të tjera që përbejnë interes për Trashëgiminë në përgjithësi.

Shafi Gashi, kryetar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi, falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën që të diskutojnë për gjendjen në Trashëgiminë Kulturore. Ai tha se në kohën kur është zgjedhur ky Këshill, gjendja nuk ka qenë e mirë. Në fillim të mandatit të tij, ky Këshill, punën kryesore e ka orientuar në plotësimin e bazës ligjore. Gashi theksoi se me plotësimin e vakuimit ligjor që kanë mbuluar, ata kanë arritur që në listën për mbrojtje të përhershme të fusin edhe 23 asete. Më tej, kryetari Gashi tregojë për vështirësitë që ka hasur Këshilli që ai drejton sa i përket ambienteve të punës dhe infrastrukturës përcjellëse, por që tani, sipas tij, me kalimin me zyrë te ndërtesa e Qeverisë, kushtet e punës janë diç më të mira. Ai ngriti nevojën që ka ky këshill për staf specialist shtesë, në fushat si arkeologji, trashëgimi të luajtshme apo edhe në atë të arkitekturës. Sipas Gashit, gjendja e trashëgimisë kulturore, të të katër kategorive është jashtëzakonisht e rëndë. Ai u zotua që të rrisë intensitetin e punës së Këshillit dhe në këtë mënyrë të zgjerohet edhe më tej lista me asete në mbrojtje të përhershme.

Nait Hasani, nga prezantimi i punës së kryetarit të Këshillit Kosovës për Trashëgimi, ngriti disa pika kryesore. Ai ngriti shqetësimin për mungesën e bashkëpunimit me KZM- në, apo edhe çështjen e dosjeve të monumenteve të përkohshme dhe që këto monumente të përfshihen në listën për asete për përhershme. Një tjetër çështje e ngritur nga Hasani ishin edhe ajo për Inspektoratin dhe Qendrën për Inventarizim.

Salih Morina tha se në mungesë të Inspektoratit, Trashëgimia po degradohet. Ai theksoi nevojën për një mobilizim më të madh mes aktorëve kryesor, siç është Zyra e Presidentit, Kryeministrit, por që bartëse kryesore duhet të jetë ministria në mënyrë që aplikimi i serishëm për UNESCO të ketë sukses. Morina pyeti përfaqësuesit e Këshillit rreth raporteve jo shumë të kënaqshme të tyre me ministrinë. Krejt në fund, Morina shtroi pyetjen se sa është numri i përgjithshëm i aseteve në listën e mbrojtjeve të përhershme.

Bekim Haxhiu, kërkoi nga përfaqësuesit e Këshillit më shumë informacione rreth gjendjes së Shtëpive Muze në lagjen e Jasharajve. Një pyetje tjetër nga Haxhiu, kishte të bënte me bashkëpunimin e këtij Këshilli me Institutin për Trashëgimi brenda Ministrisë së Kulturës.

Shpejtim Bulliqi, tha se meqë ky Këshill është organ i Kuvendit do të ishte mirë të përfshinte edhe segmentin e gjeotrashëgimisë duke e vlerësuar këtë segment të një rëndësie të madhe dhe në këtë mënyrë duke mos e kufizuar këtë Këshill vetëm në fushën e Trashëgimisë Kulturore.

Ismajl Kurteshi duke e diskutuar raportin për vitin 2015, parashtroi disa pyetje. Ndër pyetjet e parashtruara kishte të bënte nëse ka propozime konkrete nga ky Këshill për plotësim-ndryshimin e ligjit aktual. Çështje me interes për deputetin Kurteshi, përbënin edhe përfitimi i përvojave nga bashkëpunimi rajonal që ky Këshill ka pasur, bashkëpunimi me zyrat rajonale, raporti financiar, duke theksuar se në këtë raport nuk përfshihet asgjë për investimet që duhet bërë. Punimet në Artanë, zunë të jenë një interes tjetër për deputetin Kurteshi, i cili ngriti pyetjen se a po i

mbikëqyrë ky Këshill punimet aty. Trashëgimia e luajtshme që është në Beograd, ishte po ashtu një çështje tjetër e ngritur në diskutim. Sipas Kurteshit, vërejtjet e Auditorit nuk janë arsyetuar dhe adresuar.

Nait Hasani, lexoi disa nga objektet që janë të përfshira në propozim listën për intervenimin e Qendrës Historike të Prizrenit, duke pyetur se kush kujdeset për to.

Në përgjigjet e dhëna nga kryetari i Këshillit në pyetjet e parashtruara, ai u përgjigj se sa i përket Shtëpive Muze në lagjen e Jasharajve, kjo nuk është përgjegjësi e këtij Këshilli, pasi që kjo i përket Agjencisë për Memorialët. Ndërkaq, në pyetjen për përfshirjen e gjeotrashëgimisë në domenin e këtij Këshilli, ai tha se, pasi që kjo nuk është e përfshirë në ligj, ky nuk është obligim i tyre që t'i marrin në mbrojtje dhe të përkujdesen për to. Ai ngriti shqetësimin e pranisë tejet të vogël të stafit profesionist, studentëve, etj. në punimet që po zhvillohen në Artanë dhe theksoi se punëkryesi serb është zgjedhur nga vetë UNESCO. Sa i përket raportit të Auditorit, ai tha se Këshilli ka vepruar sipas afateve kohore dhe obligimeve që dalin nga aty. Në lidhje me artefaktet që gjenden në Serbi, Gashi tha se kjo është trashëgimi e Kosovës dhe duhet t'i kthehet asaj, por që Këshilli që ai drejton nuk ka forcë dhe ndikim më të madh që të bëjë që ato të kthehen në Kosovë, pavarësisht lobimit që ata kanë bërë.

5. Diskutim lidhur me sigurinë në shkolla

Në mungesë të propozueses së kësaj pike të rendit të ditës, Teuta Haxhiu, Komisioni nuk diskutojë për propozimin në fjalë.

6. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, propozoi që Komisioni të zhvillojë debat për gjendjen në arsim, ku në Komunën e Gjilanit, pa lejen e Ministrisë së Arsimit, në Shkollën e Mesme të Mjekësisë janë hapur dy paralele, kurse shkolla pa lejen e Drejtorisë Komunale për Arsim ka hapur drejtime të kundërta me të. Ai shtoi se këto drejtime janë hapur dy muaj pas fillimit të vitit akademik dhe se në këto klasë janë mbi 35 nxënës.

Ky propozim për debat në Komision nuk u përkrah nga anëtarët e tjerë të Komisionit, duke sugjeruar që kjo çështje të ngrihet në seance plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani